



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, nenit 53 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18,

*Sipas Shkresës së Ministrisë së Financave Punës dhe transfereve nr.1397 të datës 15 qershor 2021, e përcjellur nga Ministria e Pushtetit Lokal përmes Shkresës 0-519/3 të datës 18 qershor 2021 për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 30 korrik 2021, mori këtë,*

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim anulohet Rregullorja nr.prot.01-560/03-0045216/21 për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, e miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 04.06.2021.

#### **Neni 2**

Anulimi sipas nenit 1, bëhet për shkak të vlerësimit nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve shkresa nr.1397 datë 15.06.2021 gjegjësisht Zyra e Kryeministrit, *se akti në fjalë nuk është në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës nr.06/L-084, me arsyetimin se ligji në fjalë nuk ka paraparë nxjerrjen e rregulloreve të tilla nga ana e komunave, si dhe duke sugjeruar se Kuvendet komunale nuk duhet të tejkalojnë kompetencat e tyre përveç atyre të dhëna me nenin 17 (k) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, ku referohet vetëm "ofrimit të shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale për kujdesin fëmijëror.*

#### **Neni 3**

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës së Podujevës.

**Nr.01-560/03-0063169/21**  
**Podujevë,**  
**30 korrik 2021**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**